

# RRUGËT REGIONALE DHE LOKALE TË KOSOVËS VLERËSIM MJEDISOR DHE SOCIAL

## Përbledhje joteknike



Republika e Kosovës  
Ministria e Infrastrukturës

Përfundimtar  
05 Janar 2016

# RRUGËT REGJIONALE DHE LOKALE TË KOSOVËS VLERËSIM MJEDISOR DHE SOCIAL

## Përbledhje joteknike

<b>Projekti:</b>	Rrugët regjionale dhe lokale të Kosovës– Vlerësim mjedisor dhe social
<b>Raporti:</b>	Përbledhje joteknike
<b>Përgatiti:</b>	Ministria e Infrastrukturës
<b>Financoi:</b>	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
<b>Konsulenti:</b>	Enovad.o.o. Sarajevë

## Përmbajtja

<b>1</b>	<b>HYRJE.....</b>	<b>4</b>
<b>2</b>	<b>PËRSHKRIMI I PROJEKTIT .....</b>	<b>4</b>
<b>3</b>	<b>SFONDI.....</b>	<b>7</b>
3.1	Arsyeshmëria e projektit .....	7
3.2	Aspektet ligjore dhe pajtueshmëria me ligjet përkatëse në fushën e mjedisit dhe atë sociale .....	8
3.3	Gjendja dhe çështjet aktuale mjedisore dhe sociale.....	11
<b>4</b>	<b>DOBITË MJEDISORE DHE SOCIALE QË PRITET T'I SJELLË ZBATIMI I PROJEKTIT .....</b>	<b>12</b>
<b>5</b>	<b>PËRMBLEDHJE E NDIKIMEVE TË MUNDSHME MJEDISORE DHE SOCIALE TË PADËSHIRUESHME</b> <b>13</b>	
5.1	Ndikimet mjedisore dhe sociale .....	13
5.2	Ndikimet e mbeturës mjedisore dhe sociale.....	17
5.3	Ndikimet progresive.....	17
<b>6</b>	<b>PËRMBLEDHJE E MASAVE ZBUTËSE DHE MENAXHUESE MJEDISORE DHE SOCIALE .....</b>	<b>17</b>
6.1	Masat zbutëse mjedisore dhe sociale .....	17
<b>7</b>	<b>MONITORIMI .....</b>	<b>22</b>
<b>8</b>	<b>PËRMBLEDHJE E PAJTUESHMËRISË ME KP-të .....</b>	<b>22</b>
<b>9</b>	<b>KOMUNIKIMI .....</b>	<b>23</b>

## Tabelat

Tabela 1: Përshkrim i projekteve të propozuara të zgjerimit të rruget kryçese .....	6
Tabela 2: Arsyeshmëria e projektit për segmentet rrugore në të cilat do të kryhen punë ndërtimore .....	8
Tabela 3: Kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis për projektin sipas legjisacionit kombëtar .....	9
Tabela 4: Dokumentacioni për planifikim që është përpiluar për zonat e projektit.....	10
Tabela 5: Ndikimet e identikuara mjedisore dhe sociale që lidhen me zbatimin e projektit.....	13
Tabela 6: Masat zbutëse mjedisore dhe sociale .....	18

## Figurat

Figura 1: Seksionet e projektit (Burimi: Ministria e Infrastrukturës) .....	5
Figura 2: 3.2 km rrugë kryçese, Komuna e Gjilanit, segment i rrugës nationale M 25-2 (Burimi: Google Maps) ..	6
Figura 3: 5.6 km rrugë kryçese, Komuna e Ferizajt, segment i rrugës nationale M2 (Burimi: Google Maps).....	6
Figura 4: 3.8 km rrugë kryçese, Komuna e Prizrenit, segmenti i rrugës regionale R 107 (Burimi: Google Maps)	7
Figura 5: 12 km segmenti Kllokot- Gjilan i rrugës nationale M 25-3, (Burimi: Google Maps) .....	7

## 1 HYRJE

Në kuadër të Projektit përrugë lokale dhe regionale të Kosovës (në tekstin e mëtejmë, projekti), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) po e mbështetë finansiarisht Qeverinë e Kosovës për tëpërmirësuar rrjetin e rrugeve nacionale. Më saktësisht, projekti i propozuar ngërthen **zgjerimin në katër korsitërrugëve** hyrëse dhe dalëse në komunat e Gjilanit, Ferizajt dhe Prizrenit, si dhe **rikonstruimin e shtresës bazë dhe nënbazënë** trasenë ekzistuese të segmentit Kllokot - Gjilan të rruget nacionale M 25-3.

Projekti është kategorizuar si i kategorisë "B" në përputhje me Politikën Sociale dhe Mjedisore (PSM) (2014) të BERZH-it dhe, kështu, ka qenë e nevojshme të bëhet një vlerësimi mjedisor dhe social (M&S) i tij karshi kritereve përkatëse të BERZH-it për performance<sup>1</sup>.

Kjo përbledhje joteke (PJT) paraqet një përbledhje tësuazave të projektit në aspektin e kushteve bazë mjedisore dhe sociale, ndikimeve mjedisore dhe sociale, dhe masave për zbutje dhe përmirësim të rekomanduara për ta përbushur Politikën mjedisore dhe sociale të BERZH-it dhe kriteret përkatëse të performancës (KP) (2014). Është hartuar një Plan veprimi mjedisor dhe social (PVMS) për strukturimin e projektit në përputhje me KP-të e BERZH-it. PVMS përmban veprimet kyçë që Ministria e Infrastrukturës (në tekstin e mëtejmë, Ministria), si agjenci që zbaton projektin, dhe kontraktuesit e angazhuar nga ajo, duhet t'i ndërmarrin gjatë të gjitha fazave të zbatimit të projektit në mënyrë që të sigurohet përbushja e KP-ve të BERZH-it, si dhe e kritereve të parapara me legjisacionin vendor dhe atë të BE-së.

## 2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti i propozuar ngërthen **zgjerimin në katër korsi** të rrugeve hyrëse dhe dalëse në komunat e Gjilanit, Ferizajt e Prizrenit, si dhe **rikonstruimin e segmentit** Kllokot - Gjilan të rruget nacionale M 25-3. Tabela 1 paraqet një pasqyrë të përbledhur të punëve që janë paraparë për secilin segment rrugor të marrë në konsideratë në kuadër të këtij projekti, siçështë paraqitur në Figura 1.

---

<sup>1</sup> Në dispozicion në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe në:  
<http://www.ebrd.com/news/publications/policies/environmental-and-social-policy-esp.html>

Rrugët regionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësim mjedisor dhe social  
Përbledhje jotekejne





Figura 1: Sessonet e projektit (Burimi: Ministria e Infrastrukturës)


**Rrugët regionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësim mjedisor dhe social  
Përbledhje joteknike**

**Tabelaz:** Përshkrim i projekteve të propozuara të zgjerimit të rrugëve kyçëse

Segmen ti rrugor	Arsyeshmëria e projektit
<b>Segmen ti rrugor i M25-2 për kyçje në Gjilan</b>	<p><b>Përbledhje e rrugës:</b> Gjatësia e rrugës kyçësdo të jetë 2,800 m dhe do të përfshijë dy rrrethrotullime dhe infrastrukturën në vijim: instalimet elektrike, sistemi i kanalizimit, sistemi i drenazhitit të ujërave atmosferikë, shenjat e komunikacionit.</p> <p><b>Projekti i rrugës dhe trotuareve:</b> Rrugë dydrejtëmëshe me nga dy korsi për drejtim. Gjerësia e rrugës është 24.5 m (2 korsi për secilin drejtim–gjithsej 4 korsi x 3.75 m, të ndara nga një i shull 5 m i gjerë). Të dyja anët kanë të planifikuara korsi emergjente me gjerësi 2.5 m secila (2 x 2.5 m) dhe trotuare (2 x 1.5 m).</p>
<b>Segmen ti rrugor i M2 pér kyçje në Ferizaj</b>	<p><b>Përbledhje e rrugës:</b> Gjatësia: 5,600 m, katër korsi, 2 rrrethrotullime, 1 urë – gjatësia 10m, duke përfshirë infrastrukturën në vijim: instalimet elektrike, sistemi i kanalizimit, sistemi i drenazhitit të ujërave atmosferikë, shenjat e komunikacionit.</p> <p><b>Projekti i rrugës dhe trotuareve:</b> Rrugë dydrejtëmëshe me nga dy korsi për secilin drejtim, ku 2 korsi janë 3.5m të gjera dhe 2 korsi të rrugës janë njëdrejtëmëshe dhe 3m të gjera. Këto korsi ndahen nga një brez i gjelbër. Trotuaret janë të planifikuara në të dyja anët e rrugës, dhe janë të gjera 2m me brez të gjelbër në mes (gjithsej 5x1.2m breza ta gjelbër). Gjithashtu, janë planifikuar katër nënkalime për këmbësorë në katër udhëkryqe.</p>



**Figura2:** 3.2 km rrugëkyçëse, Komuna e Gjilanit, segment i rrugës nationale M 25-2 (Burimi: GoogleMaps)



**Figura3:** 5.6 km rrugëkyçëse, Komuna e Ferizajt, segment i rrugës nationale M2 (Burimi: GoogleMaps)

Segmenti rrugor	Arsyeshmëria e projektit
<b>Segmenti rrugor i R107 përkryje në Prizren</b>	<p><b>Përbledhje e rrugës:</b>  <b>LLOTI 1:</b> Gjatësia e rrugës 1,190 m duke përfshirë infrastrukturën komplete: sistemi përdrenazhimin e ujërave, shenjat e komunikacionit, sistemi i ujësjellësit, sistemi i kanalizimit, rrjeti i telefonit dhe energjisë elektrike dhe ndriçimpublik.  <b>LLOTI 2:</b> Gjatësia e rrugës 1,502 m me një rrethrrrotullim, duke përfshirë infrastrukturën në vijim: sistemi përdrenazhimin e ujërave, ujësjellësi, rrjeti i telefonisë dhe energjisë elektrike, si dhe ndriçim publik.  <b>Projekti i rrugës dhe trotuareve:</b>  <b>LLOTI 1:</b> Rugë dydrejtësme me 2 korsi përdrejtë. Gjerësia e rrugës është 3 m përkorsi.  <b>LLOTI 2:</b> Rugë dydrejtësme me 2 korsi përdrejtë. Gjerësia e rrugës është 3.5 m përkorsi.</p>  <p>Prizren</p> <p><i>Figura 4: 3.8 km rrugëkyçëse, Komuna e Prizrenit, segmenti i rrugës regionale R 107 (Burimi: GoogleMaps)</i></p>
<b>Rrugë nationale M 25-3, segmenti Kllokot - Gjilan</b>	<p><b>Përbledhje e rrugës:</b>  Gjatësia e rrugës është 12 km dhe shtrihet mes Kllokotit dhe Gjilanit.  <b>Projekti i rrugës dhe trotuareve:</b>  Rikonstruimi i shtresës bazë dhe nënbasë tërrugës njëdrejtësme me dy korsi në trasenë ekzistuese 7 m të gjërë, me 1 m gjerësi të anësorës së rrugës dhe kanale drenazhimi të hapura 1.5 m të gjera.</p>  <p>Gjilan</p> <p>Road reconstruction of National Road M 25-3 subsection Kllokot - Gjilan</p> <p><i>Figura 5: 12 km segmenti Kllokot- Gjilan i rrugës nationale M 25-3, (Burimi: GoogleMaps)</i></p>

### 3 SFONDI

#### 3.1 Arsyeshmëria e projektit

Sekcionet e projektit konsiderohen si projekte me prioritet sipas Strategjisë së Kosovës për transportin multimodal(2012-2021) dhe Planit gjegjës të veprimit (2012-2016) të Kosovës. Rruja e nationale M2 dhe rruga

**Rrugët regionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësim mjedisor dhe social**  
**Përbledhje joteke**

nacionale M25 korrespondojnëme rrugën 6 të rrjetit qendror rrugor të Observatorit të Transportit i Evropës Juglindore (SEETO)<sup>2</sup>, dhe rrugët M25-2dhe M 25-3përbëjnë degë të këtyre lidhjeve kryesore.

**Tabelaz:** Arsyeshmëria e projektit për segmentet rrugore në të cilat do të kryhen punë ndërtimore

Segmenti rrugor	Arsyeshmëria e projektit
<b>Segmenti rrugor i M25-2 për kryje në Gjilan</b>	Ky seksion përbën rrugën kryesore për hyrje në Komunën e Gjilanit nga drejtimi i kryeqytetit të vendit, Prishtina, dhe është lidhja më e shpejtë në autoudhën A1 në Republikën e Serbisë
<b>Segmenti rrugor i M2 për kryje në Ferizaj</b>	Ky seksion do të jetë rrugë tranzite për autoudhën e ardhshme B6 Prishtinë-Shkup, aktualisht në ndërtim e sipër. Kjo është lidhja me e shpejtë nga drejtimi i Prishtinës për në Shkup të Maqedonisë.
<b>Segmenti rrugor i R107 për kryje në Prizren</b>	Ky seksion është rrugë e rëndësishme për qasje në Komunën e Prizrenit nga drejtimi i Gjakovës. Sipas Strategjisë së transportit multimodal (2012-2021) dhe Planitgjegjës të veprimit (2012-2016) të Kosovës, kjo rrugë rajonale përbën një lidhje të rëndësishme në mes të qyteteve kryesore të Kosovës.
<b>Ruga nationale M 25-3, segmenti Kllokot - Gjilan</b>	Ky seksion është një rrugë e rëndësishme tranziti midis Kllokotit dhe Livoçit të Poshtëm i cili ndodhet në kufi me zonën urbane të Komunës së Gjilanit, me veprimtari afariste përgjatë rrugës, duke përfshirë fabrika përmbytje e ujit dhe banja. Gjithashtu, ajoshërben si rrugë tranziti midis komunave të Ferizajt dhe Gjilanit.

### 3.2 Aspektet ligjore dhe pajtueshmëria me ligjet përkatëse në fushën e mjedisit dhe atë sociale

Zbatimi i këtij projekti duhet të bëhet në pajtueshmëri me ligjet përkatëse vendore në fushën e mjedisit dhe atë sociale që zbatohen në Republikën e Kosovës. Direktiva për VNM<sup>3</sup>ka gjetur zbatim në legjislacionin kombëtar me *Ligjin nr. 03 / L- 214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis*, me të cilin kërkohet pëlgjim mjedisor për secilin projekt publik ose privat të renditur në Shtojcën I ose Shtojcën II të po këtij ligji, i cili mund të ketë efekte të theksuara në mjedis për arsyet e tij, mes tjerash, natyrës së tij, madhësishë ose lokacionit. VNM është i obligueshëm për të gjitha projektet e renditura në Shtojcën I, ndërsa projektet e renditura në Shtojcën II shqyrtohen rast për rast dhe në pajtim me kriteret e përcaktuara në Shtojcën III për të përcaktuar nëse ata duhet t'i nënshtrohen VNM-së. Leja për ndërtim ose ndonjë leje tjetër nuk mund të merret për projektet e renditura në Shtojcën I dhe Shtojcën II të Ligjit përdherisa të mos lëshohet pëlgjimi mjedisor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Sipas *Ligjit nr. 04/L-110 për ndërtim*, që rregullon dhënien e lejeve të ndërtimit, leja ndërtimore nuk është e nevojshme për punëndërtimoretë tilla si riparim, rinosim dhe rehabilitim-përmirësim. Për të gjitha punët ndërtimore për të cilat kërkohet leja ndërtimore nevojitet të merret gjithashtu edhe certifikata e përdorimit para se objekti të përdoret.

Blerja e tokës do të bëhet në pajtim me Ligjin nr. 03/L-139<sup>4</sup>për shpronësimin e pronës së paluajtshme, që përcakton rregullat dhe kushtet sipas të cilave Qeveria ose një komunë mund të bëjë shpronësimin e të drejtave pronësore ose të drejtave tjera në pronën e paluajtshme të një personi, shuma dhe pagesa për

<sup>2</sup> Sipas Memorandumit të mirëkuptimit për zhvillimin e rrjetit të transportit qendror rajonal të nënshkruar në qershor 2004 nga vendet pjesëmarrëse Shqipëria, Bosna dhe Hercegovina, Kroacia, ish-Republika Jugosllave Federative e Maqedonisë, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova (sipas Rezolutës 1244/99), rrjeti qendror përkufizohet si një rrjet multimodal që përfshinë rrugë, hekurudha dhe lidhje të brendshme detare në shtatë vendet pjesëmarrëse të SEETO-së së bashku me një numër të portave detare, lumore dhe nyjeve të aeroportit.

<sup>3</sup>Direktiva 2011/92/B/E e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 13 dhjetor 2011, për vlerësimin e ndikimeve që shkaktohen në mjedis nga projekte publike dhe private (siç është ndryshuar me Direktivën 2014/52/B/E)

<sup>4</sup>I miratuar në vitin 2009, dhe i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 03/L-205 për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

**Rrugët regionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësim mjedisor dhe social**  
**Përbledhje joteke**

kompensim dhe dispozitat tjera të cilat rregullojnë çështje tjera që kanë të bëjnë me shpronësimin ose kufizimin e pronësisë.

Tabela3renditë kërkesat ligjore për marrjen e lejes mjedisore sipas *Ligjet nr. 03/L-214 për vlerësimin e ndikimit në mjedis* për secilin segment në kuadër të projektit. Ministria e Infrastrukturës është agjenci zbatuese përgjegjëse që të sigurojë realizimin e procesit të VNM-së për të gjithë segmentet e projektit në pajtim me kërkesat ligjore, ndërsa Ministria e Mjedisit dëshifikim Hapësinor është autoritet verifikues për segmentet rrujore qëkategorizohen nën Shtojcën II të këtij ligji. Në kohën e botimit të këtij raporti ende nuk janë lëshuar pëlgimet mjedisore për segmentet rrujore në kuadër të këtij projekti.

**Tabela3:** Kërkesat për vlerësimin e ndikimit në mjedis për projektin sipas legjislacionit kombëtar

Segmenti rrugor	Është e obligueshme NVM (projektet e renditura në Shtojcën I)	Verifikimi për të përcaktuar në se ka nevojë për VNM (projektet e renditura në Shtojcën II)	Autoriteti që lëshon lejen	Koment
<b>Segmenti rrugor i M25-2 për kyçje në Gjilan</b> ndërtim në gjatësi prej 3.1km		X	Mbetet të përcaktohet pas procesit të verifikimit.	Nëse nuk kërkohet VNM, Komuna e Gjilanit duhet ta fillojë procedurën për dhënen e lejes mjedisore komunale
<b>Segmenti rrugor i M2</b> për kyçje në Ferizaj ndërtim në gjatësi prej 5.6 km	X		Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit	
<b>Segmenti rrugor i R107</b> për kyçje në Prizren ndërtim në gjatësi prej 2.5 km		X	Mbetet të përcaktohet pas procesit të verifikimit.	Nëse nuk kërkohet VNM, Komuna e Gjilanit duhet ta fillojë procedurën për dhënen e lejes mjedisore komunale
<b>Ruga nationale M 25-3, segmenti Kllokot - Gjilan</b> rikonstruim në gjatësi prej 12 km	-	-	-	Nuk kërkohet leje

Sipas legjislacionit kombëtar për planifikim hapësinor dhe ndërtim, për punët ndërtimore të parapara në kuadër të këtij projekti nevojiten leja urbanistike, leja e ndërtimit dhe certifikata e përdorimit dhe duhet të jepen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas pajisjes me pëlgime mjedisore.

Dokumentacioni i projektit të detajuar për punët ndërtimore që do të kryhen në kuadër të këtij projekti kërkohet si parakusht për t'u pajisur me leje ndërtimi. Projektet e detajuara tashmëjanëpërpiluar për të gjitha segmentet nga ana e kompanive të autorizuara të përzgjedhura përmes procesit të prokurimit publik nga të gjitha komunitat përkatëse. Ministria e Infrastrukturës do të revidimin e brendshëm tëprojekteve të detajuara që i kanë dorëzuar komunitat, dhe do të përgatitë tender të prokurimit publik për punë ndërtimore i cili do të përbajë Planin e veprimt mjedisor dhe social (PVMS) të hartuar në kuadër të këtij projekti.

Për rikonstruimin e rrugës nationale M 25-3, segmenti Kllokot – Gjilan, Ministria nuk ka paraparë fare projekt të detajuar. Në vend të tjetri, inxhinierët e Ministrisë do të përpilojnë njëparamasënë të cilën do të përvijohen punët ndërtimore që duhen kryer dhe kostot përkatëse.

## Rrugët regionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësim mjedisor dhe social Përmbledhje joteknike

Gjatë fazës përgatitore për këtë projekt, Ministria e Infrastrukturës e Kosovës ka nisur konsultimet me komunat e përfshira në projekt (Ferizaj, Gjilani, Prizreni dhe Suhareka) me qëllim të përcaktimit të vjetër të fundit, komunat e përfshira në projekt kanë bërë hapa për identifikimin e grupeve përkatëse të palëve të interesit dhe dhënien e informacioneve në zonën e projektit në mënyrë të vazhdueshme, qoftë përmes formave të ndryshme të takimeve formale dhe joformale midis kryetarëve të komunave dhe komuniteteve lokale, qoftë përmesdëgjimeve publike me qëllim të diskutimit të caktuar një Plan për angazhimin e palëve të interesit (PAPI).

Dëgjimet publike me komunitetet lokale janë mbajtur gjatë procesit të miratimit të planeve zhvillimore komunale, planeve zhvillimore urbane dhe planeve rregulluese urbane në komunat e Ferizajt, Gjilanit dhe Prizrenit, në përputhje me kërkesat e legjisacionit për planifikim hapësinor në Kosovë<sup>5</sup>. Në pajtueshmëri me kërkesat e KP10 të BERZH-it, në kuadër të projektit është përpiluar një Plan për angazhimin e palëve të interesit (PAPI).

Tabela 4 jep një pasqyrë të dokumenteve të planifikimit të përpiluara nga secila komunë e cilënshtohen zonat e projektit:

**Tabela 4:** Dokumentacioni për planifikim qështë përpiluar për zonat e projektit

Segmenti rrugor	Dokumentet e planifikimit të hartuara për zonën e projektit
Segmenti rrugor i M25-2 për kyçje në Gjilan	<ul style="list-style-type: none"><li>• Plani zhvillimor komunal i Gjilanit (2008)</li><li>• Plani zhvillimor urban i Gjilanit</li></ul>
Segmenti rrugor i M2 për kyçje në Ferizaj	<ul style="list-style-type: none"><li>• Plani zhvillimor komunal i Ferizajt (2011)</li><li>• Plani zhvillimor urban i Ferizajt</li><li>• Planet rregulluese urbane për rrugën M2</li><li>• Vlerësimi strategjik mjedisor për zonën e Ferizajt</li></ul>
Segmenti rrugor i R107 për kyçje në Prizren	<ul style="list-style-type: none"><li>• Plani zhvillimor komunal i Prizren (2011)</li><li>• Plani zhvillimor urban i Prizren (2011)</li><li>• Planet rregulluese urbane për zonë Parku i Biznesit (2011)</li><li>• Drafti i vlerësimit mjedisor dhe social për zonën Parku i Biznesit (2011)</li><li>• Plani zhvillimor komunal i Prizrenit 2025: Raporti për vlerësimin strategjik mjedisor (VSM) (draft) (2015)</li></ul>
Ruga nationale M 25-3, segmenti Klokot - Gjilan	<ul style="list-style-type: none"><li>• Draft-Raporti për vlerësimin e ndikimit mjedisor për zgjerimin e rrugës M25-3, Gjilan – Prishtina (2015)</li><li>• Plani zhvillimor komunal i Gjilanit (2008)</li><li>• Plani zhvillimor urban i Gjilanit</li></ul>

Pjesa dérrmuese e tokave për rrugët kyçështë blerë gjatë kohës sëish-Jugosllavisë dhe atëbotështe krijuar një brez i gjërëmbrojtës rrugor për të mundësuar zgjerimin e rrugëve nga 2 në 4 korsi. Kështu, brezi rrugor i krijuar minimizon nevojën për blerje toke në kuadër të këtij projekti. Për ndërtimin e segmentit rrugor të M25-2 për kyçje në Gjilan, nga blerja e tokës do të preken 11 ngastra toke në pronësi private. Blerja e tokës do të përfshijë kriesisht një pjesë të këtyre ngastrave<sup>6</sup>, ngaqë brezi ekzistues mbrojtës i rrugës nationale siguron hapësirë të mjaftueshme për zgjerimin. Nuk pritet të ketë asnjëzhvendosje fizike dhe në ngastrat në fjalë nuk ka objekte të cilat duhet të blihen. Informatat në dispozicion janë paraqitur në më shumë hollësi në Kornizën e blerjes së tokës (KBT), qështë përgatitur për këtëprojekt në pajtim me kërkesat e KP5 të BERZH-it.

<sup>5</sup>Liqji nr. 04/L-174 për planifikimin hapësinor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 30/23, gusht 2013

<sup>6</sup>Vetëm 3 nga 11 ngastrat do të shpronësohen në tërsi, ndërsa 8 tjerat do të shpronësohen pjesërisht.

### 3.3 Gjendja dhe çeshtjet aktuale mjedisore dhe sociale

#### Segmenti rrugor i M25-2 për kyçje nëGjilan

Zona në të cilën shtrihet ky segment rrugor ndodhet në këmbët e Maleve tëZhegocit dhe karakterizohet me relief të ndryshueshmë (kodra dhe lugina). Liqeni artificial i Livoqit ndodhet 500 m në skajin veriperëndimor të segmentit, jashtë zonës së ndikimeve të mundshme, dhe nuk pranë këtij segmenti nuk kalon asnjë vijë uji. Kjo zonë karakterizohet me klimë mesatare kontinentale, pa ndonjë lloj të veçantë të bimëve ose kafshëve të mbrojtur me ligj apo zona të mbrojtura sipas Hartës së zonave të mbrojtura të Kosovës. Të dhënat nga monitorimi i cilësisë së ajrit në Gjilan gjatë gjysmës së parë të vitit 2015 tregojnë se grimcat e ngurta (PM) janë ndër ndotësit kryesorë të ajrit. Nuk ka të dhëna për ndotjen akustike.

Ky segmentpërshkronzonën rurale të Komunës së Gjilanit dhe pjesën periferike të qytetit. Përgjatë skajeve të rrugës ndodhen shtëpitë private, objekte afariste dhe gjashtë pompa të karburanteve. Toka në afersi të rrugës, e cila ështëparaparë për zgjerim, përdoret pjesërisht për qëllime afariste. Kjo hapësirë është e rezervuar nga komuna për qëllim të zgjerimit të rrugëve. Gjatë vizitave në terren nuk është identifikuar ndonjë grup i veçantë në pozitë të cuneshme. Rrua nuk lidhë asnjë institucion ose organizatë publike që karakterizohet me fluks të madh këmbësorësh. Gjatë vizitës në terren në zonën e projektit nuk është evidentuar asnjëobjekt i trashëgimisë kulturore.

#### Segmenti rrugor i M25-2 për kyçje nëFerizaj

Ferizaj ndodhet në pjesën jugore të rrafshit të Kosovës. Kjo zonë ështëgati tërësisht e sheshtë. Pjesa më veriore e segmentit rrugor përshkoni njëdegtë të lumit Neredime. Ky segment karakterizohet nga njëklimë e butë kontinentale, dhe nuk ka të evidentuar asnjë specie të mbrojtur apo ndonjë vlerë të veçantë ekologjike. Në Hartëne zonave të mbrojtura të Kosovës nuk është identifikuar asnjë zonë e mbrojtur e cila shtrihet në zonën e projektit. Sipas Planit zhvillimor komunal të Ferizajt,ka degradim të cilësisë së ajrit për shkak të numrit të madh të automjeteve të vjetruara, djegies sëbiomasës në bujqësi dhehedhjes së paligjshme të mbeturinave. Nuk ka të dhëna për ndotjen akustike.

Sipërfaqja e tokës e destinuar për zgjerim është në pronësi të komunës dhe e planifikuar për zgjerimin e rrugës. Përgjatë këtij segmenti ndodhet një numër i vogël i objekteve të banimit të cilat janë aty-këtu. Vec kësaj, përgjatë segmentit rrugor ndodhen edhe një numër i madh punishtesh dhe objektesh afaristeqë kanëfluks të madh të automjeteve dhe këmbësorëve. Përveç trafikut të dendur, rrua kalon nëpër zonën urbane të Ferizajt dhe i ndan lagjet Bibaj dhe Talinoc. Në përgjithësi rrua karakterizohet nga shumë lidhje me rrugë dytësore të cilat kyçen në të. Gjatë vizitave në terren nuk është evidentuar asnjë grup në pozitë të cuneshme dhe as trashëgimi kulturore e çfarëdo lloji.

#### Segmenti rrugor i R107 për kyçje në Prizren

Ky segment rrugor ndodhet në një zonë të rrafshët nëafersi të së cilës nuk kalon asnjë rrjedhë uji. Klima e Prizrenit është kontinentale me njëndikim të butë të klimës mesdhetare në lartësi të ulëta, gjersësë në male dominon një klimë e ashper malore. Sipas të dhënave nga monitorimi i cilësisë së ajrit gjatë gjysmës së parë të vitit 2015, ndotës kryesor i ajrit është pluhuri (përqendrimi mesatar i PM<sub>10</sub> në janar ishte 79,77 mg/m<sup>3</sup>). Nuk ka të dhëna për ndotjen akustike. Diversiteti i florës dhe faunës është shumë i vogël, pa ndonjë evidencë të specieve të mbrojtura a tëndonjë vlore të veçantë ekologjike. Sipas Hartës së zonave të mbrojtura të Kosovës, në këtë lokalitet nuk ka zona të mbrojtura.

Rrua kalon nëpër pjesën periferike të qytetit tëPrizrenit, e cila kryesisht përbëhet nga ndërtime industriale pa vendbanime apo institucione publike në afersi. Kjo ndikon që të ketë më pak lëvizje të këmbësorëve përgjatë rrugës. Përgjatë pjesës më të madhe të rrugës ndodhen objekte të ndryshme prodhuese, tregtarë dhe afariste. Toka e destinuar për zgjerimin e rrugës është pronë komunale dhe e planifikuar për zgjerimin. Përgjatë rrugës shtrihen një numër i madh i ngastrave të tokës bujqësore me një numër të vogël të objekteve

të banimit të shpërndara aty-këtu. Gjatë vizitës në terren në këtë zonë të projektit nuk është evidentuar asnjë objekti trashëgimisë kulturore i çfarëdo lloji dhe as grupe të veçanta në pozitë të ceneshe.

### Rruja nationale M 25-3, segmenti Kllokot – Gjilan

Ky segment rrugor shtrihet në Fushën e Anamoravës, nëmes të vendbaneve të Kllokotit dhe zonës urbane të Komunës së Gjilanit, dhe karakterizohet me një relief të rrafshët dhe disa kodrina të ulëta dhe lugina. Ky segment nuk përshkon asnjë rrjedhë uji nëntokësor, mirëpo kalon mbi dy përrenj, atë të Cernicës dhe Livoqit. Për këtë segment rrugor nuk ka të dhëna nga monitorimi i ndotjes akustike ose cilësisë së ajrit. Zona përgjatë segmentit rrugor Kllokot-Gjilan përdoret kryesisht si tokë bujqësore, me toka të klasësl dhe II, të përshtatshme për lavërtari dhe kultivim të perimeve. Përgjatë këtij segmenti rrugor nuk janë identifikuar as zona të mbrojtura dhe as objekte të trashëgiminë kulturore të çfarëdo lloji. Gjithashtu, nuk është evidentuar asnjëgrup i veçantë në pozitë të ceneshe, dhe pjesa dërrmuese e popullsisë që jeton në të dyja anët e rrugës i përket komunitetit serb.

## 4 DOBITË MJEDISORE DHE SOCIALE QË PRITET T'I SJELLË ZBATIMI I PROJEKTIT

Zbatimi i projektit do të kontribuojë si në kuptim të përmirësimeve në mjedis ashtu edhe tëatyre socio-ekonomike, dhe do të ketë ndikime pozitive në cilësinë e jetës së komuniteteve lokale. Në kuadër të projektit janë identifikuar disa mundësi mjedisore dhe sociale:

- Infrastruktura e zhvilluar rrugore me qasje të përmirësuar për në dhe brendapërbrenda vendbanevenë zonat e projektit në komunat e Ferizajt, Gjilanit dhe Prizrenit;
- Zgjerimi i rrugëve nacionale/rrugës regionale do të përmirësojë lidhjet e komunave të Ferizajt, Gjilanit dhe Prizrenit në nivel kombëtar dhe rajonal (kjo do të stimulojë zhvillimin socio-ekonomik të zonave), sidomos me rrugën nacionale M2 që shpie në Shkup të Maqedonisë;
- Rindërtimi i segmentit rrugor Kllokot - Gjilani M 25 do të çojë në ulje të trafikut të dendur përgjatë këtij segmenti, që shquhet për prani të veprimtarive afariste;
- Sistem transporti rrugor më efikas dhe më i sigurt përmes shkurtimit të kohës së udhëtimit, uljes së numrit të aksidenteve rrugore, uljes së shpenzimeve të operimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, dhe uljes së kostos së transportit të mallrave, meqë projekti i ri përfshin zona të përshtatshme të destinuara për këmbësorë dhe sinjalistikë rrugore të përmirësuar;
- Rritja e cilësisë së jetës së komunitetit në përgjithësi (qasje më të mirë në shërbime kyçe: shëndetësia, arsimi, punësimetj.);
- Dobi për pasagjerët me automjete dhe shfrytëzuesit e transportit publik si rrjedhojë e zgjerimit e rrugëve nacionale/rrugës regionale ekzistuese nga 2 në 4 korsi, lidhje më të mira të trafikut dhe kapacitet më të madh të rrugës;
- Dobi për sektorin industrial dhe zhvillimin e aktiviteteve industriale si rrjedhojë e zgjerimit të rrugëve nacionale/rrugës regionale ekzistuese, përmirësimi të lidhjeve me rrugët e tjera, si dhe kursimeve të kostos dhe sigurisë në rrugë për shkak të shkarkimit të rrugës, në veçanti për sa i përket segmentit rrugor të rrugës nacionale M25-2 për kyçje në Gjilan që shquhet për prani të konsiderueshme të aktivitetit tregtar.
- Projekti pritet që të sjellë dobi për tregun lokal të punës. Gjatë fazës së ndërtimit dhe mirëmbajtjes, do të ketë nevojëqë të punësohen punëtorë dhe ata do të frekuentojnë komunitetet lokale në afërsi të vendeve të ndërtimit, gjë që do të rezultojë në mbështetje të drejtpërdrejtë për bizneset ekzistuese për shkak se atyre do t'ju rriten shitjet dhe, në mënyrë të tërthortë, do të krijojmë mundësi të rejaafaristepër biznese tjera lokale të tilla si transportues, furnizues dhe ofrues tjerë të shërbimeve;

- Projekti do të ngritisëgurinë e përgjithshme në komunikacion rrugor, për shkak se do të ofrojë hapësira të destinuara për këmbësorë, ishuj që ndajnë trafikun, sidhe për faktin se projekt i është bërë sipas standardeve të sigurisë në komunikacionin rrugor që po verifikohen nga Auditimi i sigurisë sërrugës në përputhje me Direktivën 2008/906/KE të BE-së për rruget kyçëse në Prizren, Ferizaj dhe Gjilan.

## 5 PËRMBLEDHJE E NDIKIMEVE TË MUNDSHME MJEDISORE DHE SOCIALE TË PADËSHIRUESHME

### 5.1 Ndikimet mjedisore dhe sociale

Faza e ndërtimit përfshin aktivitete ndërtimi (zgjerimi I rrugëve nacionale/ rrugës regionale ekzistuese nga 2 në 4 korsi) dhe rikonstruimit rrugës në trasenë ekzistuese, derisa faza e operimit përfshin përdorimin e përditshëm të rrugës nacionale, dhe mirëmbajtja përfshin aktivitete tëpastrimit të borës gjatë dimrit, riparime të vogla në rrugë (çarje, gropë), vendosjen e shenjave të komunikacionit etj. Gjatë fazës sëndërtimit dhe operimit, pritet të ketë një numër ndikimesh si afatgjata ashtu edhe afatshkurtra të cilat zakonisht janë të ndërlidhura me projektet infrastrukturore e që ndikojnë në cilësinë e jetës së komuniteteve lokalesi drejtpërdrejt ashtu edhe tërthorazi. Ndikimet mjedisore dhe sociale që kanë të ngjarë të paraqiten gjatë fazës sëndërtimit dhe operimit tëprojektit janë shtjelluar në Tabelën 5. Këto ndikime janë kryesisht të karakterit të përkohshëm.

**Tabela 5:** Ndikimet e identikuara mjedisore dhe sociale që lidhen me zbatimin e projektit

Ndikimet që lidhen me rikonstruimin/ndërtimin	Ndikimet që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen
Cilësia e ajrit	
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Emetimi i gazrave shkarkues</b>-nga makineria që do të përdoret gjatë fazës së ndërtimit. Kjo do të shpie në shkarkimin e gazrave sikurse SO<sub>2</sub>, CO<sub>2</sub>, CO, NO<sub>x</sub> dhe VOC. Në rast të mosfunkcionimit të duhur të motorëve (mirëmbajtja jo e duhur ose vjetërsia e makinerisë dhe automjeteve) mund të lirohen gazra potencialisht të dëmshëm;</li> <li><b>Krijimi i pluhurit</b>, ku ndotësit më të rëndësishëm janë grimcat e ngurta (PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>). Gjatë fazës së ndërtimit do të krijohet <b>pluhur</b> si rrjedhojë e aktiviteteve përgatitore të vendpunimeve (heqja dhe gërmimi i asfaltit të vjetër në rrugën ekzistuese me dy korsi) dhe aktivitetet e ndërtimit (zgjerimi i rrugëve nacionale/rrugës regionale ekzistuese nga 2 në 4 korsi). Burim tjetër i madh i pluhurit është lëvizja e mjeteve motorike për transportimin e pajisjeve nësippërfaqe të pashtuara nëpër vendpuni.</li> <li><b>Furnizimi dhe transportimi joadekuat i materialeve</b> – Ndikimet e lidhura me furnizimin dhe transportimin joadekuat shkaktohen nga transportimi i materialeve në mjete motorike të pambuluara, që mund të shkaktojnë krijimin e pluhurit dhe derdhjen e materialit ndërtimor. Ruajtja e materialeve të dheut në kushte të thata atmosferike ka të ngjarë që të çojë në krijimin e pluhurit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Gazrat e shkarkuara nga makinat</b>–Trafiku i përditshëm gjatë fazës së operimit do të shpie në emetimin e gazrave shkarkues (SO<sub>2</sub>, CO, CO<sub>2</sub>, si dhe NO<sub>x</sub>, VOC). Gjatë mirëmbajtjes së rrugëve, deo të shkarkohen gazra nga makineria e përdorur për mirëmbajtje, d.m.th. mirëmbajtja dimërore e rrugëve ose mirëmbajtja e rregullt periodike e rrugëve, së bashku me gazrat shkarkues të liruar gjatë trafikut të përditshëm;</li> <li><b>Krijimi i pluhurit</b>do të paraqitet gjithashtu gjatë fazës së operimit dhe mirëmbajtjes, ku ndotësit më kryesorëjanë grimcat e ngurta (PM<sub>10</sub> dhe PM<sub>2.5</sub>). Burimet e pluhurit përfshijnë materialet e përdorura në mirëmbajtjen dimërore të rrugëve (d.m.th. rëra, asfalti) të kryer nga kontraktuesi.</li> </ul>
<b>Ndikim i ulët<sup>7</sup></b>	<b>Ndikim mesatar</b>

<sup>7</sup> Ndikim i ulët – ndikim afatshkurtër dhe minimal që shkakton dëme minimale në një zonë të vogël të lokalizuar dhe/ose dhe nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin e njerëzve

Ndikim mesatar – ndikim afatshkurtër deri afatmesëm me dëme mesatare mjedisore në një zonë të definuar të lokalizuar ose më të gjërë dhe/ose dëm të mundshëm në shëndetin e njerëzve

**Rrugët regionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësim mjedisor dhe social  
Përmbledhje joteke**

Ndikimet që lidhen me rikonstruimin/ndërtimin	Ndikimet që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen
Nivelet e zhurmës dhe dridhjet	
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Emetimi i zhurmës dhe shqetësimet nga zhurmakanë të ngjarë të paraqiten gjatë aktiviteteve të përgatitjes sëvendpunimeve dhe aktiviteteve të ndërtimit. Burime të mundshme të zhurmës janëaktivitetet për përgatitjen e sipërfaqes se ndërtimit (d.m.th. gërmimi i asfaltit të vjetër, zgjerimi i rrugës ekzistuese, nivelimi i asfaltit të ri, përdorimi i veglave dhe pajisjeve, shkarkimi i materialeve ndërtimore sikurse zhavorri, rëra, asfalti etj.). Zhurma e krijuar gjatë aktiviteteve të ndërtimit mund të rezultojë gjithashtu edhe në shqetësimin sit ë popullatës që jeton në afërsi të vëndpunimeve ashtu edhe punëtorëve në vendpunime (në Gjilan, sidomos në fshatin Miresh, dhe shtëpitë private nëPartesh eLivoq të Poshtëm dhe në Komunën e Ferizajt);</b></li> <li><b>Dridhjet</b> gjatë fazës së ndërtimeve mund ndodhin për shkak të kundërvënieve së forcave të ndryshme të ushtruara nga gomat e automjeteve dhe sipërfaqja e rrugës, duke rezultuar në paraqitjen e parregullsive në sipërfaqen e rrugës dhe që lidhen me përdorimin e makinerisë së rendë. Dridhjet mund të ndikojnë drejtëpërdrejt tek objektet përreth, përmes themelive të objekteve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Emetimi i zhurmës dhe shqetësimet nga zhurma</b> do të ndodhin për shkak të trafikut të përditshëm që do të zhvillohet në rrugën regionale gjatë fazës së operimit (nëzona banimi nëkomunën e Gjilanit dhe Ferizajt). Komunikacioni rrugor përbën burim zhurme me intensitet dhe shpeshtësi të ndryshueshme;</li> <li><b>Dridhjet</b> mund të ndodhin për shkak të makinerisë, d.m.th. mjeteve motorike për mirëmbajtje dimërore të rrugës që përdoren në fazën e mirëmbajtjes dhe që mund të ndikojnë tek themellet e objekteve përreth apo të ndikojnë tek llojet e pakurritore tokësorë.</li> </ul>
<b>Ndikim mesatar</b>	<b>Ndikim i ulët</b>
<b>Cilësia e ujërave sipërfaqësorë ose nëntokësorë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Krijimi i kërkësës shtesë për ujë–punëtorët e punësuar dhe punëtorët e angazhuar në ndërtim mund të krijojnë kërkësë të shtuar për ujë. Uji do të përdoret kryesisht për krijimin e aggregateve për punët ndërtimore dhe për njomjen e sipërfaqeve, si edhe për nevojat ditore për konsum të ujit të punëtorëve;</b></li> <li><b>Kontaminimi i mundshëm i ujërave sipërfaqësorë</b> (Liqeni i Livoqit, Lumi i Neredimes, Lumi Sitnica) ose i ujërave nëntokësorë mund të ndodhë si rrjedhojë e substancave të dëmshme të lëshuara nga automjetet në trafikun që zhvillohet në rrugët nacionale/rrugën regionale në komunat e Ferizajt, Gjilanit dhe Prizrenit (faza e operimit), ose makineria që do të përdoret për mirëmbajtjen e rrugëve, ose rrjedhjet e materialeve ndotëse gjatë aksidenteve;</li> <li>Në fazën e operimit, ndikimet në cilësinë e ujërave sipërfaqësorë ose nëntokësorë kanë të ngjarë të shfaqen në kushte të reshjeve atmosferike. Substancat e dëmshme në rrjedhat e ujit të shkaktuara nga trafiku rrjedhin nga djegia e karburanteve (grimca dhe gazra), gjerryerja e gomave dhe frenave, si dhe rrjedhjet nga automjetet (karburante, vaj etj.). Një nga ndikimet më të rrezikshme në mjedis mund të shfaqet nga rrjedha e materieve ndotëse gjatë aksidenteve;</li> <li>Mirëmbajtja dimërore e rrugëve përfshin përdorimin e materialeve që sigurojnë fërkimin e gomave dhe të kripës, e që mund të shpie në rritjen e salinitetit të ujërave sipërfaqësorë ose nëntokësorë.</li> </ul>
<b>Ndikim mesatar</b>	<b>Ndikim i ulët</b>
<b>Gjeomorfologjia dhe cilësia e tokës</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Largimi i dheut</b>– do të ndodhë si rrjedhojë e zgjerimit nga 2 • Kontaminimi i mundshëm i tokës mund të ndodhë</li> </ul>	

Ndikim i madh – ndikim afatmesëm deri afatgjatë me dëme të mëdha në një zonë të gjerë dhe/ose që shkakton dëme serioze në shëndetin e njerëzve

**Rrugët regionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësim mjedisor dhe social**  
**Përmbledhje joteke**

Ndikimet që lidhen me rikonstruimin/ndërtimin	Ndikimet që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen
<p>në 4 korsi të rrugëve ekzistuese nacionale në Ferizaj e Gjilan dhe rrugës regionale në Prizren;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li><b>Kontaminimi i mundshëm i tokës</b>–mund të ndodhë si rrjedhojë e aktivitetave të përgjithshme të ndërtimit dhe praktikave të këqija të ndërtimit (shih Ndikimet në ujëra sipërfaqësorë/ujëra nëntokësorë më sipër);</li> <li><b>Erozioni</b>– mund të ndodhë për shkak të mungesës së njësistemi të mirëfilltë të drenazhit;</li> <li><b>Ngjeshja e dheut në hapësirën përreth</b> – makineritë e ndërtimit që lëvizin në zonat në të cilat shtrihen rrugët nacionale/rruga regionale mund të shpjinë në ngjeshje të dheut, ta dëmtojnë rendimentin e tokës dhe drenazhimin.</li> </ul>	për shkak të lëshimit të substancave të dëmshme nga trafiku i automjeteve (faza e operimit) ose makineritë që do të përdoret për mirëmbajtjen e rrugëve, ose rrjedhjet e lëndëve ndotëse gjatë aksidenteve (shih Ndikimet në cilësinë e ujërave sipërfaqësorë më sipër).
<b>Ndikim mesatar</b>	<b>Ndikim i ulët</b>
<b>Shfrytëzimi i tokës</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Ndryshimet në ndryshimin e tokës(d.m.th.)</b> nga tokë bujqësore në tokë/zonë për ndërtim;</li> <li><b>Pengimi i shfrytëzimit të tokës</b> si rrjedhojë e menaxhimit joadekuat të mbeturinave, gjegjësisht mungesës së kontrollit dhe trajtimit të mbeturinave (d.m.th, derdhjet aksidentale nga makineria e ndërtimit, mbeturinat e ngurta të krijuara nga punëtorët në vendpunishte) që mund të janë të dëmshme për komunitetet lokale.</li> </ul>	Gjatë fazës së operimit dhe mirëmbajtjes nuk priten ndikime domethënëse për sa i përket shfrytëzimit të tokës.
<b>Ndikim mesatar</b>	/
<b>Burimet biologjike dhe ekologjike</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Pengimi i specieve të shtazëve</b> si rrjedhojë e krijimit të pluhurit gjatë punës së makinerisë, si edhe dridhjet që mund të ndikojnë tek specie e pakurizorëve tokësorë;</li> <li><b>Degradimi i burimeve biologjike</b>–kontaminimi i mundshëm i ujit dhe tokës me substancat e dëmshme mund t'i dëmtojë kurrizorët dhe pakurizzorët tokësorë. Megjithatë, segmentet në kuadër të projektit gjenden në zona shumë të urbanizuara qëndur kanë ndonjë vlerë ekologjike dhe biologjike.</li> </ul>	/
<b>Ndikim i ulët</b>	/
<b>Menaxhimi i mbeturinave</b>	
Projekti do të ngërthejë largimin e asfaltit ekzistues dhe largimin e dheut. Si rrjedhojë e operimit të makinerive do të gjegjerohen gjithashtu edhe mbetje vajrash dhe lubrifikantësh.	
<b>Ndikim i ulët</b>	
<b>Peizazhi dhe aspektet pamore</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Ndryshim i pjesshëm i peizazhit dhe aspektave pamore</b>–mund të pritet të ndodhë si rrjedhojë e organizimit të vendpunimeve, dërgimit dhe ruajtjes së përkohshme të materialeve ndërtimore, rritjes së trafikut dhe pranisë së personelit dhe makinerive në vendin e punimeve. Ndryshimet e pritura tëpeizazhit dhe aspektave pamore do të janë paksë të dukshme për popullsinë lokale.</li> </ul>	Gjatë fazës së operimit dhe mirëmbajtjes nuk priten ndikime domethënëse nëpeizazh dhe në aspektet pamore, përvèç nëse mirëmbajtja kërkon tëbëhen punë shtesë për përmirësimin e segmenteve rrugore e që mund të variojnë varësisht nga lloji dhe vëllimi i punëve.
<b>Ndikim i ulët</b>	<b>Ndikim i ulët</b>
<b>Trafiku</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Trafiku i dendur dhe pengesa</b> në rrugë– qarkullimi i shtuar i automjeteve, që shpie në trafik të dendur dhe në pengesa, ka të ngjarë të ndodhë nëpër rrugë lokale gjatë zhvillimit të aktivitetave të ndërtimit (zgjerimi i rrugëve nacionale të propozuara në komunat e Ferizajt e Gjilanit, si dhe në rrugën regionale në Komunën e Prizrenit) dhe rikonstruimit të segmentit tëM 25-3 Kllokot – Gjilan meqë gjatë rikonstruimit do të mylllet për qarkullimit njëra korsi. Një gjë e tillë pritet të ndodhë sidomos gjatë furnizimit më materiale ndërtimore në vendin e punimeve dhe mbledhjes sëmbeturinave nga aktivitetet ndërtimore;</li> <li><b>Krijimi i kanaleve dhe pjerrinave</b> – ka të ngjarë të shfaqet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li><b>Trafiku idendur</b> – aktivitete të caktuara të mirëmbajtjes, d.m.th. mirëmbajtja dimërore e rrugëve, kanë të ngjarë të shpjinë në ngadalësim të trafikut dhe paraqitjes së mundshme bllokimeve të trafikut, ngaqë mjetet motorike për mirëmbajtje lëvizin më ngadalë krahasuar me automjetet tjera që qarkullojnë në rrugët nacionale/rrugën regionale.</li> </ul>

**Rrugët regionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësim mjedisor dhe social**  
**Përbledhje joteke**

Ndikimet që lidhen me rikonstruimin/ndërtimin	Ndikimet që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen
<p>gjatëaktivitetetëve ndërtimore sikurse ruajtja e përkohshme e materialeve ndërtimore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndikimet që lidhen me qasjen përfshijnë kryesisht kufizimet në qasje për shkak punëve ndërtimore, dhe pritet të jenë të përkohshme. Edhe pse rrugët do të mbeten e hapur për qarkullim gjatë fazës së ndërtimit, bizneset lokale të vendosura në afërsi të vendpunimeve të planifikuara mund të përballen me qasje të kufizuar gjatë periudhës sa zgjasin punimet në rrugë dhe, si rrjedhojë, rënien fitimesh nga udhëtarët për shkak të pakësimit të trafikut.</li> </ul>	
<b>Ndikim mesatar</b>	<b>Ndikim i ulët</b>
	<b>Siguria e punëtorëve</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Gjatë aktivitetetëve të ndërtimit, punëtorët do të jenë të eksposuar ndaj sëmundjeve dhe lëndimeve në punë, të shkaktuara nga dridhjet dhe zhurma, bartja e ngarkesave, shkathtësitë joadekuante për operimin me makineri ndërtimore dhe orari i zgjatur i punës.</li> </ul>	/
<b>Ndikimi mesatar</b>	<b>/</b>
	<b>Blerja e tokës</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Për qëllimet e projektit pritet të jetë e nevojshme të blihet tokë nëmësë më të vogël. Blerja e tokës do të jetë e nevojshme vetëm për qëllimin e zgjerimit të rrugës për kyçje në Gjilan, në Komunën e Gjilanit. 11 ngastra (tëklasifikuara si tokë ndërtimore sipas planit të ri rregullues urban për zonën, që mbulon gjithashtu rrugën kyçëse në Gjilan) do të preken, kryesisht me qëllim të ndërtimit të rrethrotullimeve gjatë zgjerimit të rrugës. Nuk pritet të ketë asnjëzhvendosje fizike. Përmasat e sakta të aktivitetetëve për blerjen e tokës do të dihen pas shqyrtimit dhe finalizimit të projekteve zbatuese për të gjithë segmentet, që do të përfshijnë studimet e shpronësimit të përgatitura në përputhje me Ligjin e Kosovës për shpronësimin e pronës së paluajtshme.</li> <li>Blerja e tokës do të jetë e përhershme ("shpronësim i plotë"), për t'i mundësuar përfituesit të shpronësimit ta marrë titullin pronësor mbi pasurinë e shpronësuar, ndërsa të drejtat e pronarit të mëparshëm nëpronën e paluajtshme shuhën.</li> </ul>	/
<b>Ndikim i madh</b>	<b>/</b>
	<b>Kufizimet e shfrytëzimit të tokës dhe dëmtimi i pronës private</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Pritet që të jetë e nevojshme që të merren në shfrytëzim të përkohshëm disa ngastra toke në pronësi private për qëllime të sistemimit të punëtorëve, makinerisë dhe materialeve. Aktivitetet ndërtimore kanë mundësi të shkaktojnë dëme në ngastra, gardhe e rrethoja.</li> </ul>	/
<b>Ndikim i madh</b>	<b>/</b>
	<b>Kushtet e jetës së komunitetetëve lokale</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Ndikimet negative u referohen shqetësimeve të komunitetetëve përreth vendpunimeve si rrjedhojë e: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ shtimit të zhurmës</li> <li>○ hedhjes së mbetjeve ndërtimore</li> <li>○ ndërpërjeve të mundshme të furnizimit me ujë dhe energji elektrike, lidhjeve të telefonisë dhe internetit, shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave dhe transportit të regjult publik.</li> </ul> </li> </ul>	/
<b>Ndikim mesatar</b>	<b>/</b>

## 5.2 Ndikimet e mbetura mjedisore dhe sociale

Ndikimet e mbetura mjedisore nënkuuptojnë ndikimet që kanë të ngjarë të vazhdojnë edhe pasi të janë aplikuar masat zbutëse. Ndikimet e mbetura mjedisore nuk pritet të janë të mëdha nëse janë zbatuar masa zbutëse, menaxhimi i duhur i mjedisit dhe praktikat më të mira të ndërtimit dhe operimit. Këto ndikime mund të përfshijnë: emetimet në ajër (gazratshkarkuese dhe kriji i pluhurit), kontaminimin e tokës dhe ujit (derdhjet dhe rrjedhjet aksidentale nëtrafik).

## 5.3 Ndikimet progresive

Ndikimet progresive kanë të ngjarë të shfaqen si rrjedhojë e trafikut në fazën e operimit, për shkak të:

- Emetimeve të zhurmës dhe dridhjeve të cilat mund të rezultojnë në shqetësim në zonën përreth,
- Emetimet e lëndëve ndotëse në ajër nga djegia e karburanteve të përdorura për automjete dhe makineri (që do të shpie në sedimentim të lëndëve ndotëse në sipërfaqe të rrugës dhe në tokën përreth në një gjerësi prej 8-10 m përgjatë rrugës. Këto lëndë ndotëse kanë të ngjarë të kenë një ndikim negativ në cilësinë e tokës, ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, veçanërisht kur kemi të bëjmë me metale të rënda.

# 6 PËRMBLEDHJE E MASAVE ZBUTËSE DHE MENAXHUESE MJEDISORE DHE SOCIALE

## 6.1 Masat zbutëse mjedisore dhe sociale

Gjatë fazës para fillimit të ndërtimit, kontraktuesit duhet të hartojnë planet e mëposhtme të menaxhimit:

- Planin e zbutjes dhe monitorimit mjedisor dhe social gjatë ndërtimit (PZMMSN) dhe Planin e zbutjes dhe monitorimit mjedisor dhe social gjatë operimit (PZMMSO), që duhet të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në çështjet e mëposhtme: pluhuri/ndotja e ajrit, erozioni i tokës/ndotja e ujit, organizimi i vendpunimeve, menaxhimi i zhurmës, ruajtja e burimeve ekologjike, rreziqet aksidentale (plani i reagimit ndaj derdhjeve dhe reagimet emergjente), menaxhimi i trashëgimisë kulturore, menaxhimi i trafikut duke përcaktuar rrjedhën e trafikut gjatë punimeve, me një theks të veçantë në sigurinë e trafikut<sup>8</sup>)
- Planin për shëndet dhe siguri (Plani SH&S), që përmban rreziqet e identifikuara tëprojektit dhe rreziqet e lidhura me vendin e punimeve të cilat duhet të merren në konsideratë, si dhe organizimi i menaxhimit të vendit të punimeve.
- Planin emenaxhimit të mbeturinave (PMM), me theks të veçantë në menaxhimin e mbetjeve të rrezikshme dhe mbetjeve nga ndërtimi dhe shembja.
- Studimin për sigurinë nga fatkeqësitetë natyrore dhe fatkeqësitetë tjera për projekte për zgjerimin nga 2 në 4 korsi të segmenteve rrugore në kuadër të këtij projekti, në bazë të nenit 58 të Ligjit nr. 04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitetë natyrore dhe fatkeqësitetë tjera.

Masat zbutëse mjedisore dhe sociale gjatë **fazës para fillimit të punëve ndërtimore, fazës së ndërtimit** dhe **fazës së operimit** janë paraqitur më poshtë (Tabela6).

<sup>8</sup>Në pajtim me Politikën sociale dhe mjedisore për vitin 2014 të BERZH-it dhe me qëllimet e Direktivës 2008/96/KE të 19 nentorit 2008 për menaxhimin e sigurisë së infrastrukturës rrugore.

**Rrugët regjionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësim mjedisor dhe social**  
**Përbledhje joteknike**

**Tabela 6:** Masat zbutëse mjedisore dhe sociale

Ndikimi i mundshëm	Masat zbutëse të propozuara
<b>Faza para ndërtimit</b>	
Blerje toke	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Marrja në konsideratë e ndryshimeve të vogla të trasesë në dokumentacionin e projektit kurdoherë që të jetë e mundshme</li> <li>• Zbatimi i KBT (dhe përpilimi i PBT për segmentet përfshin masat përmesave, kohëzgjatjes së punimeve)</li> </ul>
Kushtet e jetesës së komuniteteve lokale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i PSM-së, posaçërisht i dispozitave për informimin paraprak të komuniteteve lokale sa i përket përmesave dhe kohëzgjatjes së punimeve</li> <li>• Përpilimi i PZMMSN-së që përfshin masat përmesave, kohëzgjatjes së punimeve</li> </ul>
Trafiku	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përpilimi i Auditimit të sigurisës rrugës (ASRR) në pajtim me Direktivën e BE-së 2008/906/KE nga konsulenti i pavarur i emëruar nga BERZH-i për sa i përket projekteve të detajuara përfshin masat përmesave, kohëzgjatjes së punimeve</li> <li>• Zbatimi i PSM-së, posaçërisht i dispozitave për informimin paraprak të komuniteteve lokale sa i përket përmesave, kohëzgjatjes së punimeve</li> <li>• Përpilimi i iPZMMSN-së që përfshin masat përmesave, kohëzgjatjes së punimeve</li> </ul>
<b>Faza e ndërtimit</b>	
Cilësia e ajrit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i PZMMSN-së që përfshin masa përmesave, kohëzgjatjes së punimeve</li> <li>• Për makinerinë dhe automjetet që do të përdoren në aktivitetet ndërtimore duhet të ketë leje përdorimi/operimi</li> <li>• Makineritë dhe automjetet duhet t'i kenë të instaluar filtrat përvazgësimin e emetimit të blozës</li> <li>• Automjetet duhet të mirëmbahen rregullisht</li> <li>• Pajisjet dhe makineria duhet të fiken kur nuk janë duke u përdorur</li> <li>• Si lëndë djegëse përmesave, kohëzgjatjes së punimeve</li> <li>• Në rrugët e pashtuara, shpejtësia maksimale e automjeteve duhet të kufizohet në 20 km/h</li> <li>• Vendpunimet duhet të njomen/lagen përfshin masat përmesave, kohëzgjatjes së punimeve</li> <li>• Rëra dhe zhavorri duhet të transportohen në kamionë të mbuluar</li> <li>• Zbatimi i PZMMSN-së dëshira Planit përfshin masat përmesave, kohëzgjatjes së punimeve</li> </ul>
Nivelet e zhurmës dhe dridhjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i nivelit të zhurmës në rrugën kyçëse në Ferizaj përfshin masat përmesave, kohëzgjatjes së punimeve</li> <li>• Zbatimi i PZMMSN-së që përfshin masa përmesave, kohëzgjatjes së punimeve</li> <li>• Kryerja e punimeve vetëm gjatë ditës (nga ora 07:00 deri 19:00)</li> <li>• Për makinerinë dhe automjetet që do të përdoren në aktivitetet ndërtimore duhet të ketë leje përdorimi/operimi</li> <li>• Pajisjet dhe makineria duhet të fiken kur nuk janë duke u përdorur</li> <li>• Në rrugët e pashtuara, shpejtësia maksimale e automjeteve duhet të kufizohet në 20 km/h</li> <li>• Në rast të ankesave përfshin masat përmesave, kohëzgjatjes së punimeve</li> </ul>

<sup>9</sup>Sipas nenit 6 të Ligjit nr. 02/L-102 përmesave përfshin masat përmesave, kohëzgjatjes së punimeve, nivelet e zhurmës, dridhjet, vlerësimi i nivelit të zhurmës, etj.

**Rrugët regionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësim mjedisor dhe social**  
**Përbledhje joteknike**

Ndkimi i mundshëm	Masat zbutëse të propozuara
Cilësia e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i PZMMSN-së që përfshin masa për ndotjen e ujit</li> <li>• Monitorimi i konsumit të ujit</li> <li>• Është e nevojshme të angazhohen kompani të autorizuara për shkatërrimin përfundimtar të mbeturinave, ndërsa vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ndarjes së mbetjeve të rezikshme dhe menaxhimit të mirëfilltë të mbetjeve të rezikshme</li> <li>• Duhet të instalohen sisteme të grumbullimit të vajrave dhe karburanteve me qëllim të parandalimit të rrjedhjeve</li> <li>• Automjetet dhe makineritë duhet të mirëmbahen rregullisht në mënyrë që të parandalohen rrjedhjet</li> <li>• Instalimi i separatorëve të vajrave gjatë ndërtimit të rrugëve nacionale M25-2, M25, M2 / rrugës regionale R107 në pajtim me standardin EN 858-1 dhe 858-2</li> <li>• Zbatimi i PZMMSN-së që përfshin masa për rreziqet aksidentale (plani i reagimit ndaj derdhjeve dhe reagimi emergjent) për të siguruar ruajtjen dhe trajtimin e përshtatshëm të substancave të rezikshme, duke përshirë këtu hidrokarburet</li> <li>• Plani për SH&amp;S</li> </ul>
Gjeomorfologjia dhe cilësia e tokës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i PZMMSN-së që përfshin masa për erozionin e tokës</li> <li>• Shtresa e sipërme e dheut nga gropat për nxjerrjen e dheut duhet të ruhet dhe të futet sërisht për rivegjetimin e gropave</li> <li>• Gërmimi dhe mbushja e gropave për nxjerrjen e dheut dhe i hapësirave përreth tyre duhet tëbëhet në mënyrë korrekte nga pikëpamja mjedisore</li> <li>• Është e nevojshme të angazhohen kompani të autorizuara për shkatërrimin përfundimtar të mbeturinave, ndërsa vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ndarjes së mbetjeve të rezikshme dhe menaxhimit të mirëfilltë të mbetjeve të rezikshme</li> <li>• Është e nevojshme të instalohen sisteme të grumbullimit të vajrave dhe karburanteve me qëllim të parandalimit të rrjedhjeve</li> <li>• Është e nevojshme të instalohen struktura të drenazhimit përmes drenazhimin e duhur të ujit</li> <li>• Është e nevojshme të ketë kontroll gjatë punëve të dheut me qëllim që të parandalohet degradimi i stabilitetit të terrenit</li> <li>• Lëvizja e makinerive dhe pajisjeve në zonën përreth rrugës regionale duhet të bëhet nëmënyrë korrekte nga pikëpamja mjedisore dhe duhen shmanjur lëvizjet e panevojshme në zonat natyrore</li> </ul>
Shfrytëzimi i tokës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Toka e caktuar për përdorim për nevojat e projektit mund të përdoret vetëm për aktivitete ndërtimore dhe nuk mund të përdoret asnjë ngastër tjetër si, për shembull, për ruajtjen e materialeve ndërtimore, parkimin e makinerisë së rëndë etj. me qëllim të parandalimit të përdoret asnjë ngastër tjetër si, për shembull, për ruajtjen e materialeve ndërtimore, parkimin e makinerisë së rëndë etj., me qëllim të mbrojtjes së vendndodhjes së shtazëve</li> <li>• Është e nevojshme të angazhohen kompani të autorizuara për shkatërrimin përfundimtar të mbeturinave, ndërsa vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ndarjes së mbetjeve të rezikshme dhe menaxhimit të mirëfilltë të mbetjeve të rezikshme</li> <li>• Është e nevojshme të instalohen sisteme të grumbullimit të vajrave dhe karburanteve me qëllim të parandalimit të rrjedhjeve</li> <li>• Hedhja e mbeturinave në deponinë e përkohshme për mbetje ndërtimore të përcaktuar nga komuna kompetente</li> </ul>
Burimet biologjike dhe ekologjike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i PZMMSN-së që përfshin masat për ruajtjen e burimeve ekologjike dhe biologjike</li> <li>• Toka e caktuar për përdorim për nevojat e projektit mund të përdoret vetëm për aktivitete ndërtimore dhe nuk mund të përdoret asnjë ngastër tjetër si, për shembull, për ruajtjen e materialeve ndërtimore, parkimin e makinerisë së rëndë etj., me qëllim të mbrojtjes së vendndodhjes së shtazëve</li> <li>• Rrethimi i vendpunimeve me rrethoja me qëllim të parandalimit të rënies së shtazë të vogla në kanale</li> <li>• Zbatimi i Planit përmes menaxhimit e mbeturinave</li> <li>• Parandalimi dhe mbajtja në kontroll e derdhjeve të vajrave, karburanteve dhe kimikateve</li> </ul>

**Rrugët regionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësim mjedisor dhe social**  
**Përbledhje joteknike**

Ndikimi i mundshëm	Masat zbutëse të propozuara
Peizazhi dhe aspektet pamore	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i PZMMSN-së</li> <li>Zbatimi i Planit për menaxhimin e mbeturinave</li> <li>Aktivitetet ndërtimore duhet të kufizohen në vendpunimet e përcaktuara</li> </ul>
Trafiku	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i PZMMSN-së që përfshin masa për menaxhimin e trafikut</li> <li>Për ta menaxhuar trafikun, duhet të instalohen shenjat e duhura të trafikut</li> <li>Për ta parandaluar krijimin e kanaleve dhe pjerrinave duhet të bëhet rrafshimi i dheut</li> <li>Zbatimi i PSM-së, posaçërisht i dispozitave për informimin paraprak të komuniteteve lokale sa i përket fillimit të punimeve, kohëzgjatjen e pritur të punimeve, rrugët alternative etj.</li> </ul>
Menaxhimi i mbeturinave	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i Planit për menaxhimin e mbeturinave për të siguruar klasifikimin dhe ruajtjen e duhur të mbeturinave</li> <li>Ripërdorimi i asfaltit ekzistues në shtresat e poshtme të trotuarit të ri</li> <li>Ripërdorimi i materialeve të dheut si material për mbulim në deponitë në afërsi</li> </ul>
Siguria e punëtorëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>Plani për SH&amp;S</li> </ul>
Kufizimet e shfrytëzimit të tokës dhe démtimi i pronës private	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i PZMMSN-së që përfshin masat për organizimin e vendpunimeve</li> <li>Shmangia ose rënia përqark pronave dhe aseteve ekonomike që ndodhen në rrugët ndërtimore për aq sa është e mundur</li> <li>Shfrytëzimi i përkohshëm i tokës në pronësi private të kompensohet në para, siçështë paraparë me Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme</li> <li>Të jepet kompensim për çfarëdolloj dëmesh të shkaktuara, në pajtim me legjisacionin vendor për dëmshpërblime</li> </ul>
Kushtet e jetës të komuniteteve lokale	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i PZMMSN-së që përfshin masat për menaxhimin e trafikut, menaxhimin e pluhurit/zhurmës, si dhe masat për shëndetin dhe sigurinë e komunitetit</li> <li>Informimi në kohë i qytetarëve për çfarëdolloj shqetësimesh apo bezdish në pajtim me PSM</li> </ul>
<b>Faza e operimit</b>	
Cilësia e ajrit	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i PZMMSO-s që përfshin masa për menaxhimin e automjeteve</li> <li>Masë potenciale sigurie është krijimi i brezit të gjelbër mbrojtës i cili do t'i absorbojë pjesërisht ndotësit (<math>CO_2</math>), ngaqë cilësia e ajrit varet nga trafiku i automjeteve i cili nuk mund të kontrollohet</li> </ul>
Nivelet e zhurmës dhe dridhjet	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i PZMMSO-s që përfshin masa për menaxhimin e zhurmës</li> <li>Në rast të ankesave për zhurmë nga banorët lokalë, duhet të ulet kufiri i shpejtësisë së automjeteve</li> <li>Gjendja e re e rrugëve nacionale/rrugës regionale të zgjeruar do të ndihmojë që të ulen dridhjet, për shkak se segmentet rrujore në fjalë do të përmirësohen nëkrahasim me gjendjen në të cilën janë tani dhe, përrnjohojë, nuk do të ketë nevojë për masa të zbutjes</li> </ul>
Cilësia e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i PZMMSO-s që përfshin masa për derdhjen aksidentale të materialeve të rezikshme dhe mirëmbajtjen e sistemeve të drenazhit</li> <li>Në rast të derdhjeve aksidentale në trafik, është e nevojshme të përdoren absorbentë</li> <li>Mirëmbajtja e rregullt e separatorëve të vajrave (mbetjet vajore nga separatori duhet t'u dorëzohen kompanive të autorizuara)</li> <li>Zbatimi i PZMMSO-s që përfshin masa për derdhjen aksidentale të materialeve të rezikshme</li> <li>Prokurimi dhe përdorimi i adsorbentëve gjatë trafikut të përditshëm</li> </ul>
Gjeomorfologjia dhe cilësia e tokës	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i PZMMSO-s që përfshin masa për derdhjen aksidentale të materialeve të rezikshme</li> <li>Në rast të derdhjeve aksidentale në trafik, është e nevojshme të përdoren adsorbentë</li> </ul>

**Rrugët regjionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësim mjedisor dhe social  
Përbledhje joteknike**

Ndikimi i mundshëm	Masat zbutëse të propozuara
Trafiku	<ul style="list-style-type: none"><li>• Zbatimi i PZMMSO-s që përfshin që përfshin masa për menaxhimin e trafikut</li><li>• Informimi në kohë i qytetarëve përmes mediave për punimet e ardhshme me qëllim të mirëmbajtjes, kohëzgjatjen e pritur të punimeve, rruget alternative etj. në pajtim me PSM</li></ul>

## 7 MONITORIMI

Për të siguruar monitorim dhe raportim adekuat të aktiviteteve në kuadër të projektit, propozohet të ndërmerren masat e mëposhtme të monitorimit të efektivitetit të masave të përcaktuara të zbutjes sëndikimeve mjedisore dhe sociale dhe zbatimit të tyre nga kontraktorët:

Gjatë ndërtimit, përmes inspektiveve të rregullta nga kontraktuesit dhe inxhinieri mbikëqyrës do të monitorohen aspektet sa vijon: cilësia e ajrit, emetimet e zhurmës, largimi i ujërave të zeza, konsumi i ujit, menaxhimi dhe ruajtja e mbeturinave në bazat e logistikës dhe në vendpunishte, evidencat për shkatërrimin e mbeturinave, mbrojtja e burimeve biologjike dhe ekologjike nëpërmjet rrethimit të përshtatshëm të vendpunishtes, menaxhimi dhe ruajtja e substancave të rrezikshme, pajisjet për reagim ndaj derdhjeve, procedurat dhe trajnimi i personelit, zbatimi i planit për SH&S, zbatimi i Kornizës së blerjes së tokës, vendndodhja e kampeve të punëtorëve dhe të vendparkimeve të makinerisë së rëndë, zbatimi i PSM-së, në veçanti i dispozitave mbi informimin në kohë të qytetarëve përmes mediave në lidhje me punët ndërtimore të ardhshme, kohëzgjatjen e mundshme të punimeve, rrugët alternative dhe menaxhimin e trafikut.

Gjatë operimit, Ministria e Infrastrukturës do të jetë përgjegjëse për monitorimin e rregullt të:

- Zbatimit të PZMMSN-së që përfshin masa për pluhurin/ndotjen e ajrit, menaxhimin e zhurmës, ndotjen e ujit, erozionin e tokës, ruajtjen e burimeve ekologjike, menaxhimin e trafikut, organizimin e vendpunimeve, rreziqet aksidentale (plani i reagimit ndaj derdhjeve dhe reagimit emergjent), masat për shëndetin dhe sigurinë e komunitet;
- Zbatimin e Planit për menaxhimin e mbeturinave;
- Zbatimin e Planit për SH&S;
- Zbatimin e KBT për procedurat e kompensimit;
- Zbatimin e PSM-së;
- Zbatimin e PZMMSO-sqë përfshin masa për menaxhimin e automjeteve, menaxhimin e zhurmës, derdhjen aksidentale tëlendëve të rrezikshme dhe mirëmbajtjen e sistemit të drenazhit, menaxhimin e trafikut.

Sipas Marrëveshjes për kreditinë të nënshkruar me BERZH-in, Ministria e Infrastrukturës është e obliguar të raportojë BERZH-it çdo vit sa i përket performancës mjedisore dhe sociale të projektit.

Raporti për vlerësimin mjedisor dhe social përmban një tabelë me Planin e monitorimit lidhur me zbatimin e masave të sipërpërmendura zbutëse.

## 8 PËRMBLEDHJE E PAJTUESHMËRISË ME KP-të

**KP1:** *Pajtueshmëri e pjesshme.* Është identifikuar se nuk ka sistem të menaxhimit mjedisor dhe social (SMMS) dhe burime njerëzore për zbatim efikas të SMMS-së. Vlerësimi mjedisor dhe social i projektit, Plani për angazhimin e palëve të interesit (PAPI) dhe mekanizmi i ankesave janë realizuar. Sipas PVMS-së, është paraparë që për çështjet mjedisore dhe sociale që kanë të bëjnë me projektin të themelohet Njësia për zbatim të projektit (NJZP) në kuadër të Ministrisë, si dhe të përpilohet Plani për menaxhimin & monitorimin mjedisor & social të ndërtimit (PMMMSN) në mënyrë që të sigurohet një qasje sistematike ndaj menaxhimit të çështjeve mjedisore dhe sociale.

**KP 2:** *Pajtueshmëri e pjesshme.* Ministria dhe projekti janë në pajtueshmëri me kërkeshat e KP2 në pjesën më të madhe, me përjashtim të kërkeshave të lidhura me punëtorëve të punësuar përmes kontraktorëve ose

ndërmjetësve tjerë. Sipas PVMS-së, dokumentet e tenderit do të përfshijnë kërkesa lidhur me KP2 për palët e treta.

**KP 3:** *Pajtueshmëri e pjesshme.* Në planet ekzistuese të Ministrisë për menaxhimin dhe monitorimin e mjedisit janë identifikuar disa dispozita lidhur me pakësimin dhe parandalimin e ndotjes. Në PVMS janë përfshirë aktivitete për zbutjen e rreziqeve nga ndotja. Këto përfshijnë masat për të siguruar kryerjen e vlerësimit të ndikimeve të zhurmës në objektet e banimit që ndodhen në afërsi deri zom nga rruga, duke u kerkuar palëve të tretë që t'i zbatojnë procedurat në pajtim me PZMMSN dhe PZMMSO.

**KP4:** *Pajtueshmëri e pjesshme.* Është identifikuar se nuk ka politika me shkrim dhe kapacitetinstitucionaltë mjaftueshëm për shëndetin dhe sigurinë në punë (SHSP). Në PVMS janë përfshirë aktivitete qëkanë të bëjnë me hartimin e Planit për shëndet & siguri. Për rrugët kyçëse në Prizren, Ferizaj dhe Gjilan po realizohet njëauditim i sigurisë së rrugës (ASRR) në pajtim me Direktivën 2008/906/KE të BE-së.

**KP5:** *Pajtueshmëri e pjesshme.* Sipas PVMS-së, zbatimi i Kornizës së blerjes së tokës (KBT) është paraparë për ata segmentë të projektit për të cilët kërkohet blerje toke.

**KP 6:** *Pajtueshmëri e plotë.* Projekti nuk ndodhet në zona të mbrojtura, dhe në zonën e projektit nuk ndodhet asnjë lloj i shtazëve apo bimëve të mbrojtura. PVMS parashev kriterin që palët e treta të aplikojnë masa për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit gjatë aktiviteteve ndërtimore në kuadër të PZMMSN.

**KP 8:** *Pajtueshmëri e plotë.* PVMS parashev krijimin e Procedurës së gjetjeve rastësore për zonën e projektit.

**KP 10:** *Pajtueshmëri e pjesshme.* Projekti ka përbushur pjesërisht kërkesën për mekanizmin e ankesave, derisa Planii angazhimit të palëve të interesit (PAPI) për projektin është hartuar. PVMS përfshin kërkesën për zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të PMS-së dhe ngritjes së një mekanizmi tëveçantë të ankesave për projektin.

## 9 KOMUNIKIMI

Informatat e kontaktit për pyetjet dhe ankesat lidhur me projektin:

Drejtori i NJZP  
Ministria e Infrastrukturës  
Adresa: Ish Ndërtesa e Gërmisë  
10000, Prishtinë  
T: +383 38200-28-507, E-mail: mi.info@rks-gov.net

Në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë (<http://mi-ks.net/>) do të publikohen dokumentet dhe informatat në vijim në lidhje me projektin:

- Kjo Përbledhje joteke (PJT) e projektit;
- Plani për angazhimin e palëve të interesit (PAPI);
- Përshkrimi i projektit dhe informata të përditësuarës në lidhje me përparimin në zbatimin e projektit;
- Informata rreth rreziqeve dhe ndikimeve në shëndetin dhe sigurinë e komunitetit (përfshirëçfarëdondalesash të pritshme të qasjes në rrugë dhe punët ndërtimore), si dhe masat e propozuara të zbutjes;
- Korniza e blerjes së tokës (KBT) dhe planet për blerjen e tokës (PBT);
- Përbledhja e përfundimeve të arritura në takimet konsultative dhe diskutimet publike që janë mbajtur;
- Përbledhja e raporteve për monitorimin e zbatimit të projektit;

**Rrugët regionale dhe lokale të Kosovës – Vlerësim mjedisor dhe social  
Përbledhje joteknike**

- Formulari për ankesë dhe formulari për kërkesë për informata.